

VENDIM
Nr. 558, datë 29.9.2021

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 160, DATË 19.2.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MBËSHJETJEN FINANCIARE TË STUDENTËVE TË
SHKËLQYER DHE TË NËPUNËSVE CIVILË (FONDI I EKSELENCËS)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 4, e 112, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas nënndarjes “v”, të shkronjës “a”, të pikës 2, shtohet nënndarja “vi”, me këtë përmbajtje:

“vi. nuk kanë përfituar më parë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, brenda fondeve buxhetore të miratuara për Fondin e Ekselencës, për një program tjetër studimi të ciklit të dytë.”.

b) Pas nënndarjes “v”, të shkronjës “b”, të pikës 2, shtohet nënndarja “vi”, me këtë përmbajtje:

“vi. nuk kanë përfituar më parë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, brenda fondeve buxhetore të miratuara për Fondin e Ekselencës, për një program tjetër studimi të ciklit të tretë (doktoratë).”.

c) Pas pikës 16 shtohet pika 16/1, me këtë përmbajtje:

“16/1. Studentët, që ndjekin studimet në vitet e ndërmjetme dhe kanë përfituar bursë nga Fondi i Ekselencës, vijojnë me përfitimin e bursës edhe në rastet kur institucioni i arsimit të lartë nuk i ka vlerësuar me nota për shkak të pandemisë së shkaktuar nga infeksioni i COVID-19, me kusht që nota mesatare e ponderuar në përfundim të studimeve të jetë jo më pak se nota 8.”.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama